




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Nr. Prot
Br. Prot
Prot No. 01-1514/2012
Date
Date 25.04.2012

DATE/A:	24.04.2012
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	z. Kreshnik Basha Udhëheqës i Zyrës se Caritasit Zviceran
CC:	z. Mark Komani Drejtore i Departamentit të Administratës në Kuvendin e Gjakovës
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Preteni Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin "Ndërtimi i 35 Shtëpive për RAE " Ali Ibra" Gjakovë.

Të nderuari,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 pika 12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1 pika 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin " Ndërtimi i 35 Shtëpive për RAE " Ali Ibra" Gjakovë. me numër prokurimit CaCH 11 001 151 ofron këtë:

OPINION

Ju si autoritet kontraktues Zyra Prokurimit –Caritasit t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të cekura në arsyetim, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës nr. 04-L/042.

Arsyetim

Autoritet kontraktues, në dosjen e tenderit "Punë " të procedurës së hapur me nr. të prokurimit Ca CH 11 001 151 me titull "Ndërtimi i 35 Shtëpive për RAE , "Ali Ibra " Gjakovë , në Pjesën, Seksioni II, Fleta e të dhënave të tenderit te neni 8.1 i Dosjes së tenderit , Kërkesat mbi gjendjen ekonomike financiare, ka kërkuar: Dëshmi mbi pranimin e projekteve te realizuara ndërsa te neni 8.2 pika 1 i të njëjtës faqe ka kërkuar: **Raport mbi pranimin e punëve nga Organi**

Mbikëqyrës në emër të kontratave të prezantuara, ndërsa gjatë vlerësimit të tenderit ne formularin standard të raportit të vlerësimit si pik të vlerësimit ka marr (raportet e pranimeve teknike).

Gjatë intervistës me anëtarët e komisionit vlerësues se pse është vepruar në këtë mënyrë (ka mospërputhje në mes dosjes së tenderit dhe raportit të vlerësimit) gjatë procesit të vlerësimit të tenderit përfaqësuesit nuk janë në gjendje të japin një sqarim adekuat.

Vërejtje : Autoriteti kontraktues me rastin e vlerësimit të tenderit duhet tu përmbahet dosjes së tenderit dhe kërkesave të paraqitura në dosje të tenderit.

O.E “Euro Ing“ – nga Rahoveci me rastin e tenderimit në ofertën e tyre te faqja 35/35, te pjesa II Përmasa dhe Para llogaria – Gradacioni për punët e kryera e ka ndarë në dy pjesë : Konstruksioni i objektit 100 vite dhe instalimet 10 vite. Plotësimi dhe dorëzimi i ofertës nga “Euro Ing” ne kundërshtim me nenin 27 dhe 59 te LPP Nr. **03/L-241**, këtë operator e konsideron si te papërgjegjshëm që në fillim.

Operatorët Ekonomik tjerë të cilët kanë ofertuar në këtë tender kanë ofertuar ashtu si është kërkuar në dosje te tenderit d.m.th.: i janë përmbajtur dosjes së tenderit konformë kërkesave të Autoriteti Kontraktues.

Vërejtje : O.E tenderues me rastin e marrjes së dosjes së tenderit duhet t’iu përmbahet asaj dosje dhe kërkesave të paraqitura në dosje të tenderit, por nëse ka paqartësi në dosje të tenderit atëherë O.E ka afatin ligjor gjatë kohës se tenderimit për kërkesa dhe sqarime shtesë sipas **nenit 53 të LPP Nr. 03/L-241**.

Më datë 05.09.2011 komisioni vlerësues ka bërë vlerësimin e tenderit dhe në bazë të raportit të vlerësimit nga 36 operator ekonomik sa kanë ofertuar 32 O.E janë konsideruar si të papërgjegjshëm ndërsa vetëm katër (4) O.E, sipas komisionit vlerësues janë konstatuar se kishin dokumentacion te kompletuar.

Komisioni vlerësues kishte propozuar që O.E “ Mag – Holding SHPK & Korben” të shpërblehet me kontratë ngase kishte grumbulluar numrin më të madhe të pikëve.

A.K kishte aprovuar propozimin e komisionit vlerësues dhe kishte shpërblyer me kontratë këtë O.E duke bere publikimin edhe në web faqen e KRPP-së më datë 14.09.2011.

Më datë 23.09.2011 O.E “ Euro Ing” nga Rahoveci ka paraqitur ankesë në OSHP në bazë të nenit 105 të LPP-së.

Më datë 24.10.2011 OSHP-ja nxjerr vendim mbi aprovimin e ankesës së O.E “ EUROING” Rahovec nr.277/11, ku aprovohet si e bazuar ankesa e O.E ankues , dhe urdhërohet O.E të kthej këtë tender në rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues bënë rivlerësimin e ofertave me anëtarët e njëjtë të komisionit vlerësues dhe konstaton se O.E “EuroIng” është i papërgjegjshëm me arsyetimin e ndarjes së ofertës për

garancinë e punëve të kryera atë të konstruksionit dhe të instalimeve gjë që bën të pamundur krahasimin e ofertave të dhëna nga O.E të cilët kanë ofertuar unik dhe te pa ndarë.

Më datë 17.11.2011 OSHP nxjerrë një urdhëresë ku A.K Caritasi zviceran dënohet me gjobë në vlerë prej 5000 € dhe rekomandon Menaxherin e AK të merr masa ndaj komisionit të vlerësimit.

Autoriteti kontraktues më datë 20.12.2012 kërkojnë nga KRPP-ja interpretim në pyetjen citojmë : “ A ka të drejt O.E të bëjë ndërhyrje apo modifikime në Dosjen e Tenderit”

Përgjigjja e KRPP-së: O.E nuk ka të drejt, edhe nëse e tërheq Dosjen e Tenderit në mënyrë elektronike, ai nuk ka të drejtë ligjore të bëjë ndërhyrje apo modifikim në këtë dokument. Sipas nenit 53 të këtij ligji brenda afatit të përcaktuar në Dosjen e Tenderit të përgatitur nga A.K në pajtim me këtë nen , mund të bëj kërkesë me shkrim te A.K për çfarëdo informate ose sqarim shtesë që i nevojitet operatorit në fjalë për përgatitjen e tenderit përkatës.

Me respekt!